

VENDIM
Nr. 8, datë 19.11.2018

**PËR TRANSFERIMIN E FUNKSIONIT TË MBLEDHJES SË TARIFAVE PËR TË
GJITHA KATEGORITË E MBAJTËSVE TË TË DREJTAVE TË AUTORIT DHE TË
DREJTAVE TË TJERA TË LIDHURA ME TO, NË ADMINISTRIMIN KOLEKTIV DHE
DREJTIMIN E SPORTEELIT UNIK TË ADMINISTRIMIT TË SË DREJTËS SË AUTORIT
- SUADA**

Në zbatim të nenit 138, të ligjit nr. 35, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.1.2017, “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit”; të vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 2, datë 20.4.2017, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”; të vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit nr. 5, datë 11.10.2018, “Për hapjen e procedurave për konkurrim nga agjencitë e administrimit kolektiv për zgjedhjen e agjencisë unike, për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve (sporteli unik)”,

Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në mbledhjen e vet të radhës, datë 19.11.2018, me rend dite miratimin e agjencisë në favor të së cilës kalon funksioni kolektiv i mbledhjes së tarifave të shpërblimit, në kuptim të nenit 138, të ligjit 35/2016, si dhe drejtimin prej saj të sportelit unik SUADA, mori në shqyrtim dosjet me propozimet e mëposhtme:

a) Strategjia e AKDIE-s për Sportelin Unik për të Drejtat e Autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, me nr. protokollin hyrës nr. 16, datë 29.10.2018;

b) Platforma e përbashkët e Agjencisë ALBAUTOR dhe GRAMM-A për drejtimin e Sportelit Unik të Administrimit të së Drejtës së Autorit SUADA, nga ana e Agjencisë ALBAUTOR dhe drejtuesit ekzekutivë të saj, me nr. protokollin hyrës nr. 17, datë 30.10.2018;

Propozimet e paraqitura të agjencisë AKDIE dhe ALBAUTOR-GRAMM-A parashtrojnë informacion lidhur me përmbushjen e kushteve të nenit 138, të ligjit 35/2018, dhe kanë paraqitur strategjinë se si duhet të drejtohet sporteli unik SUADA.

Gjithashtu, përveç dokumenteve shkresore të depozituara, palët prezantuan me përfaqësuesit e tyre pranë KKDA-së, në mbledhjen e datës 19.11.2018, platformat përkatëse për drejtimin e sportelit unik SUADA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe i prezantimeve të projektpropozimeve, KKDA-ja arsyeton se platforma e paraqitur nga ALBAUTOR-GRAMM-A përmbush kriteret dhe është më e përshtatshme dhe efektive në kryerjen e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit dhe të formës së bashkëpunimit me organet shtetërore. Gjithashtu, KKDA-ja vlerëson faktin që ky propozim ka ardhur si një frymë bashkëpunimi nga dy agjenci të administrimit kolektiv, i cili është edhe një nga parimet në përmbushjen e detyrave të sportelit unik.

KKDA-ja, në vlerësimin e platformës së agjencisë AKDIE, shpreh dyshime lidhur me suksesin e strategjisë së propozuar në formën e bashkëpunimit me organet shtetërore.

Gjithashtu, KKDA-ja, në vijim edhe të eksperiencës së kaluar për drejtimin e SUADA-s, vlerëson se drejtimi i ri i SUADA-s duhet të jetë me një afat të përcaktuar për të vlerësuar performancën e saj.

Sa më sipër, duke administruar të gjithë informacionin e nevojshëm dhe pas shqyrtimit të platformave të paraqitura, Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit, në zbatim të nenit 138, të ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”,

VENDOSI:

1. Transferimin e funksionit të mbledhjes së tarifave për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave

të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në administrimin kolektiv, në bazë të nenit 138, të ligjit 35/2016, Agjencisë së Administrimit Kolektiv ALBAUTOR, me drejtor ekzekutiv z. Erlir Puto, deri në datë 31 dhjetor 2019, sipas propozimit të përbashkët të AAK-ve ALBAUTOR dhe GRAMM-A.

2. Pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, zbatohet neni 138, i ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

3. Mënyra dhe përqindjet e ndarjes së tarifave dhe të shpërblimit të mbledhur ndaj AAK-ve të kryhet në zbatim të pikës 3, të nenit 138, ligjit 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

4. Për sa nuk bien ndesh me këtë vendim, pikat e miratuara në vendimin nr. 4, datë 10.10.2017, të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, “Për transferimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, drejt njëres prej agjencive të administrimit kolektiv dhe për drejtimin e Sportelit Unik për Administrimin e së Drejtës së Autorit - SUADA”, zbatohen nga SUADA.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, si dhe në Fletoren Zyrtare.

6. Kundër vendimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit, palët kanë të drejtë të ankohen në gjykatën kompetente, brenda afateve të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative. Afati i ankimit, llogaritet nga data e njoftimit të këtij vendimi.

7. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
Ines Muçostepa